




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Gjakovës
OPŠTINA DJAKOVICA
MUNICIPALITY OF GJAKOVË

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

Duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në Nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 10 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011, si dhe Ligjin Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 01/09 Janar 2018) për vitin 2018, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT
NË MES TË
MPMS, KOMUNËS SË GJAKOVËS DHE GRUPIT PARLAMENTAR 6+
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "MBËSHTETJE KOMUNITETEVE"
KOMUNA E GJAKOVËS

Palët Nënshkruese


Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së, z.Izedin Bytyqi, (në tekstin e mëtejme MPMS);

dhe

Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z.Ardian Gjini, (në tekstin e mëtejme Komuna).

dhe

Grupi Parlamentar 6+, i përfaqësuar nga Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës Duda Balje, Danush Ademi, Albert Kinolli, Fikrim Damka, Mufëra Srbica-Šenik, Bahrim Šabani.



Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është financimi i projektit **“Mbështetje Komuniteteve si dhe përcaktimi i obligimeve të MPMS-së dhe komunës së Gjakovës, për realizimin e projektit në fjalë.**

Neni 2

Vlera e projektit dhe mënyra e financimit

1. Projekti **“Ndërtimi i pesë (5) Shtëpive për Banim Social” me Sipërfaqe 65m² për komunitetin Rom** në komunën e Gjakovës ka vlerë parallogaritë prej 50,000.00€.

Neni 3

Obligimet e Ministrisë së Punës dhe Mirqenies Sociale

1. Në afat prej pesë (5) ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje i drejtohet me shkresë Komunës që të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm të pronësisë, projektin e shtëpive, lejeve të ndërtimit dhe dorëzimin e listës me emra dhe adresa të përfituesëve, për të cilët do të ndërtohen shtëpitë e banimit.
2. Obligohet që për projektin **“Ndërtimi i Pesë (5) Shtëpive për Banim Social”**, t'i zhvillojë procedurat në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. dhe të Ligjit Nr. 04/L-194 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.
3. Të zhvillojë procedurat dhe kryej procesin e tenderimit, caktojë komisionin e hapjes dhe vlerësimit të tenderit, nënshkrimin e kontratës.
4. Të emërojë menaxherin e kontratës i cili në bashkëpunim me menaxherin/organin mbikqyrës të Komunës bënë menaxhimin e kontratës. Nëse hasë në parregullësi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MPMS-së.

5. Të formojë komisionin e përbashkët me 3 anëtarë nga MPMS dhe 2 anëtarë nga Komuna për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.

6. Të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundojë gjatë vitit buxhetor 2018, ndërsa në rast të mospërfundimit të projektit gjatë vitit 2018, për ndonjë arsye të caktuar ose të vonesave për fillimin e punimeve për ndërtimin e shtëpive, MPMS mbetet përgjegjëse për obligimet kontraktuale.

Neni 4 **Obligimet e Komunës**

1. Obligohet t'i krijojë kushtet e nevojshme për realizimin e projektit **"Ndërtimi i pesë (5) shtëpive për banim social"**, për operatorin ekonomik dhe të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që kontraktuesi pa pengesa të filloi në implementimin (furnizimin) e projekteve me kohe si dhe të siguroj specifikacionin teknik.

2. Komuna në bashkëpunim me grupin parlamentar 6+, e dorëzon në MPMS-në listën e përfituesve nga ky projekt. i cili dokumentacion krijon mundësi për fillimin e zbatimit të projektit dhe zhvillimin e procedurave të tenderimit

2.1 Obligohet të sigurojë kushtet urbanistike (në rastet ku kërkohen), projektin ideor dhe kryesor, paramasën dhe parallogarinë në kuadër të projektit për shpalljen e tenderit, lejen e ndërtimit, kyçjen në rrjetin elektrik, ujësjellës dhe kanalizim.

3. Obligohet të caktoj projekt menaxherin/organin mbikëqyrës i cili me përgjegjësi të plotë duhet të mbikqyrë në mënyrë profesionale dhe të vazhdueshme punimet në teren, të vërtetoj sasisë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës, po ashtu së bashku me operatorin ekonomik do të kontrollojë gjendjen e shtëpive gjatë periudhës obliguese të të metave (defekteve) dhe në rast të nevojës të bëhen intervenimet për eliminimin e tyre.

4. Obligohet të njoftojë MPMS-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit.

5. Obligohet të njoftojë MPMS-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas progresit të punimeve deri në përfundim të projektit.

Neni 5
Obligimet e grupit Parlamentar 6+

1. Grupi 6+ i propozon Komunës listën e përfituesve nga rradhët e komuniteteve, që do të jenë përfitues të këtij projekti.
2. Grupi 6+ e cakton nga një person kontaktues nga secili komunitet për të monitoruar ecurinë e realizimit të këtij projekti dhe të informojë grupin 6+.

Neni 6
Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Sekretarit të MPMS-së dhe Kryetarit të Komunës së Gjakovës Marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MPMS-le mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstatonë se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 7
Zgjidhja e marrëveshjes

Palët pajtohen në mes veti në rast të paraqitjes të ndonjë mosmarrëveshjeje gjatë zbatimit, çështjet të zgjidhen me mirëkuptim.

Neni 8
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në katër kopje, nga dy kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 9
Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kalojë në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).
3. Projekti do të bartet në pronësi të përfituesit sipas ligjeve në fuqi


Neni 10
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillojë të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Izedin Bytyqi
Sekretar i Përgjithshëm i
MPMS-së



Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së
Gjakovës



Prishtinë



Grupi Parlamentar 6+

